



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1884, datë 19.04.2012

Për

“Disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit në zbatim, të sipërmarrësit Albtelecom Sh.A.”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 19.04.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit në zbatim, të sipërmarrësit Albtelecom Sh.A.,”

BAZA LIGJORE:

1. Shkronja c) e nenit 8, neni 52, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
2. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918 (**Rregullorja e Brendshme**);
3. Rregullore nr. 19 datë 14.06.2010 për “Aksesin dhe Interkoneksionin” miratuar me VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar (**Rregullorja**);
4. Rregullore nr. 13 datë 16.04.2010 për “ Portabilitetin e Numrit” (e ndryshuar), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1219, Datë 07.04.2010.

5. Vendimi nr. 1742 datë 20.12.2011, i Këshillit Drejtues të AKEP për “Shfuqizimin e VKD nr.1439, datë 3.11.2010 “Disa ndryshime në VKD nr. 1348, date 26.07.2010 “ Për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom Sh.A., me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me pakicë të telefonisë fikse dhe tregjet me shumicë të interkoneksionit të telefonisë fikse””;
6. Rregullore nr. 24 datë 02.02.2012 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për Autorizimin e Përgjithshëm” miratuar me VKD Nr.1774, datë 02.02.2012.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i praktikës dokumentare mbi çështjen, të përbërë nga:

1. Shkresa e sipërmarrësit Albtelecom Sh.A. Nr.438/2 Prot., datë 17.02.2012 “Mbi depozitimin në AKEP të amendimeve të RIO-s së Albtelecom në përputhje me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1774 dt 02. 02. 2012 dhe VKD nr. 1742 dt. 20. 12. 2011.
2. Relacion shpjegues mbi projektvendimin (*Relacioni*) ;
3. Projektvendim i KD të AKEP për “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit në zbatim të sipërmarrësit Albtelecom Sh.A.” (*Projektvendimi*);
4. Materialet shkresore shoqëruese bashkëlidhur praktikës dokumentare mbi çështjen, si dhe, diskutimeve në mbledhje dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N :

1. Sipërmarrësi Albtelecom Sh.A., me shkresën Nr.438/2 Prot., datë 17.02.2012 “Mbi depozitimin në AKEP të amendimeve të RIO-s së Albtelecom në përputhje me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1774 dt 02. 02. 2012 dhe VKD nr. 1742 dt. 20. 12. 2011 drejtuar AKEP-it, parashtron propozimet e tij për amendimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit në zbatim, për implementimin e akteve rregullatore të nxjerra nga AKEP-i, konkretisht:
 - Vendimi nr. 1742, datë 20.12.2011, i Këshillit Drejtues të AKEP për “Shfuqizimin e VKD nr.1439 datë 3.11.2010 “Disa ndryshime në VKD nr. 1348, date 26.07.2010 “ Për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom Sh.A., me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me pakicë të telefonisë fikse dhe tregjet me shumicë të interkoneksionit të telefonisë fikse””;
 - VKD, Nr. 1774, datë 02. 02. 2012 “Për Miratimin e dokumentit “Rregullore për Autorizimin e Përgjithshëm”.
2. Propozimet e sipërmarrësit Albtelecom Sh.A. për amendimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit në zbatim, konsistojnë në:
 - a. Shtesa në nenin 4 “Baza Juridike”, duke shtuar pikat 2/2, 2/3, 3/4, 3/5, 3/6, 3/7, 3/8, 3/9, 5/i, 5/k dhe pika 6, 7, si dhe ndryshon paragrafi i parë i pikës 5 si më poshtë:

- 2/2 Vendimin nr. 1742 dt. 20.12.2011, i Këshillit Drejtues të AKEP për “Shfuqizimin e VKD nr.1439 datë 3.11.2010 “Disa ndryshime në VKD nr. 1348, date 26.07.2010 “ Për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom Sh.A., me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me pakicë të telefonisë fikse dhe tregjet me shumicë të interkoneksionit të telefonisë fikse””;
- 2/3 Vendimin nr. 1774 dt. 02. 02. 2012 “Për miratimin e dokumentit “Rregullore për Autorizimin e Përgjithshëm”;
- 3/4 Rregulloren nr. 16, datë 16. 04. 2010 “Për treguesit e cilësisë”, miratuar me VKD Nr. 1256, datë 16. 04. 2010;
- 3/5 Rregulloren nr. 18, datë 11. 06. 2010 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, miratuar me VKD Nr. 1296, datë 11. 06. 2010;
- 3/6 Rregulloren “Për portabilitetin e numrit” miratuar me VKD Nr. 1219, datë 07. 04. 2010;
- 3/7 VKD Nr. 1318, datë 14. 06. 2010 “Për miratimin e specifikimeve teknike për portabilitetin e numrit”;
- 3/8 Rregullore Nr. 17, datë 16. 04. 2010 “Për Administrimin e Kodeve të Pikave të Sinjalizimit Kombëtar (NSPC) dhe Ndërkombëtar (ISPC) për interkoneksionin e rrjeteve, miratuar me VKD Nr. 1257, datë 16. 04. 2010;
- 3/9 Rregullre Nr. 22, datë 24. 06. 2011 “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllorë dhe rrjeteve me fibra optike ndërrurbane të komunikimeve elektronike”.
5. Operatori përfitues, si kusht për fillimin e negociatave me Albtelecom paraqet së bashku me kërkesën për interkoneksion:
- Çertifikatën e Konfirmimit të Njoftimit;
 - Autoizimin Individual për caktimin dhe përdorimin e frekuencave (në rast se do të përdorë frekuenca);
 - Autorizimin Individual për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike.
- Kërkesa duhet gjithashtu të përmbajë informacionin e nevojshëm për të mundësuar zgjidhjen teknike dhe komerciale të akses interkoneksionit të tilla si ...
- 5/i Parashikimi për trafikun që do të shkëmbehet të jepet i detajuar siç është parashikuar në Aneks 8 “Parashikime dhe Porosia për Kapacitete pika 3.
- 5/k Historikun e të dhënave për trafikun e gjeneruar nga abonentët e Operatorit përfitues (origjinim/tranzitim/terminim) siaps raporteve të dorëzuara në AKEP periodikisht.
6. Kërkesa do të konsiderohet e tillë vetëm pas plotësimit me të gjithë dokumentat dhe informacionet e sipërpërmendura si dhe të dhënat e detajuara të specifikuara në nenin 9, pika 2/1.

7. Në rastin e operatorëve ekzistues, paraqitja e Çertifikatës së Konfirmimit të Njoftimit, përditësimit të informacionit parashikuar në nenin 9, pika 2/1 dhe pika 2/2 dhe përputhshmëria me këto kërkesa, është kusht për të mundësuar vazhdimin e ofrimit të shërbimeve të interkoneksionit.
- b. Ndryshimin e pikës 2/1 në nenin 9 “Interkoneksioni me rrjetin Albtelecom”, si më poshtë:
- 2/1 Ndërmjet të dhënave të detajuara që duhet të paraqiten së bashku me kërkesën për interkoneksion janë edhe:
- 1) Njoftimin nga AKEP për caktimin e Kodit(ëve) të Pikës(ëve) të Sinjalizimit (SPC kombëtare) sipas rekomandimeve të SS7 dhe në përputhje me Rregulloren për Administrimin e NSPC dhe ISPC dhe Rregulloren Nr. 24, datë 02. 02. 2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm”.
 - 2) Operatori Përfitues që kërkon të terminojë apo tranzitojë trafik ndërkombëtar në rrjetin Albtelecom, përveç sa më sipër, duhet të disponojë dhe të paraqesë pranë Albtelecom:
 - a) Njoftimin nga AKEP për caktimin e Kodit ndërkombëtar të Pikës së Sinjalizimit (ISPC) sipas rekomandimeve të SS7 dhe në përputhje me Rregulloren për administrimin e NSPC dhe ISPC dhe Rregulloren Nr. 24, datë 02. 02. 2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm”.
 - b) Kopje të marrëveshjes së Operatorit Përfitues me Operatorin Ndërkombëtar ku të jetë vendosur edhe ISPC e Operatorit Ndërkombëtar.
 - c) Përshkrim i lidhjeve të mbrojtura me të paktën dy operatorë ndërkombëtarë dhe kriteret e SLA-së së tyre.
 - 3) Informacion lidhur me numrin e abonentëve ekzistues të Operatorit Përfitues në momentin e paraqitjes së kërkesës për interkoneksion, të vërtetuar nga evidencat përkatëse.
 - 4) Informacionin lidhur me garantimin e parametrave e cilësisë sipas nenit 5 të Rregullores për Akses dhe Interkoneksion, Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit bashkëngjitur Marrëveshjes së Interkoneksionit dhe standardeve të aplikuara në Treguesit e Cilësisë Shërbimit (QoS).
 - 5) Dokumentin përkatës nga AKEP lidhur me aftësinë për të kryer rrugëzimin e duhur të thirrjeve, sipas përcaktimeve të Rregullores “Për Portabilitetin e Numrit”.
 - 6) Informacion mbi aksesin nga përdoruesit e Operatorit Përfitues drejt numrave të emergjencës dhe garantimin e informacionit për identifikimin e vendodhjes së personit që ka kryer thirrjen.
 - 7) Informacionin për garantimin e mundësisë për lejimin e përgjimeve të komunikimeve elektronike nga autoritetet kompetente në përputhje me legjislacionin në fuqi për përgjimet në fushën e komunikimeve elektronike.
- 2/2 Operatori Përfitues duhet të garantojë në çdo kohë kërkesat e mëposhtme rregullatore. Mosrespektimi i ndonjë prej tyre, i jep Albtelecom të drejtën për

pezullimin e shërbimit deri në rivendosjen e situatës sipas standardeve dhe parashikimeve rregullatore:

- a) *Garantimin e parametrave të cilësisë për çdo shërbim gjatë gjithë kohës që rrjetet janë të interkonektuara sipas nenit 5 të Rregullores për Akses dhe Interkoneksion, Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit bashkëngjitur Marrëveshjes së Interkoneksionit dhe standardeve të aplikuara në Treguesit e Cilësisë Shërbimit (QoS).*
 - b) *Garantimin e aksesit në çdo kohë ngapërdoruesit e Operatorit përfitues drejt numrave të emergjencës dhe garantimin e informacionit për identifikimin e vendodhjes së personit që ka kryer thirrjen.*
 - c) *Garantimin në çdo kohë të mundësisë për lejimin e përgjimeve të komunikimeve elektronike nga autoritetet kompetente në përputhje me legjislacionin në fuqi për përgjimet në fushën e komunikimeve elektronike.*
 - d) *Publikim e ndërfaqeve të përdorura për ofrimin e shërbimeve.*
 - e) *Garantimin në çdo kohë të sigurisë, integritetit dhe mirëmbajtjes së funksioneve të rrjeteve të komunikimit elektronik.*
 - f) *Garantimin dhe sigurimin e mbrojtjes së të dhënave personale në lidhje me të dhënat nga trafiku i shëmbyer mes palëve në përputhje me Direktivën e EU mbi mbrojtjen e të dhënave dhe Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.*
- c. Ndryshimin e përkufizimit të shërbimit të terminimit në rrjetin Altelecom dhe shtohet përkufizimi i shërbimit të terminimit të trafikut ndërkombëtar, në Aneks 1 “Përkufizime”, si më poshtë:

“Shërbimi terminimit Altelecom”

Shërbimi nëpërmjet të cilit Altelecom, në emër të Operatorit Përfitues përcjell Thirrjet nga Pika e Interkoneksionit për në një Pikë fundore të Rrjetit të tij në Republikën e Shqipërisë, të identifikuar nëpërmjet numrave gjeografikë të abonentëve/pajtimtarëve të Altelecom (hiqet togfjalëshi: sipas planit të numeracionit).

“ Shërbimi i terminimit të trafikut ndërkombëtar në Altelecom ”

Shërbimi nëpërmjet të cilit Altelecom, në emër të Operatorit Përfitues përcjell Thirrjet ndërkombëtare, të tranzituara nga ky i fundit, nga Pika e Interkoneksionit për trafikun ndërkombëtar për një Pikë fundore të rrjetit të tij në Republikën e Shqipërisë, të identifikuar nëpërmjet numrave të abonentëve/pajtimtarëve të Altelecom.

- d. Një shtesë tek pika 4.1 dhe shtesën e pikës 4.4 në Aneks 6 “Çështje teknike”, si më poshtë:

4.1 ...Ky kapacitet konfigurohet i ndarë sipas kategorisë së trafikut, dedikuar veçmas për trafik kombëtar dhe veçmas për atë ndërkombëtar.

4.4. *Albtelecom rezervon të drejtën të shkëpusë kapacitetin e lidhur për trafikun ndërkombëtar. Nëse Operatori përfitues nuk e përdor fare këtë kapacitet për një periudhë 2(dy) mujore.*

e. Një shtesë në pikën 7.3 në Aneks 6 :Çështje teknike”, si më poshtë:

7.3Kodi ndërkombëtar i Pikës së Sinjalizimit (International Signaling Point Code-ISPC) i centralit të Operatorit Përfitues është:

ISPC _____

3. Përveç sipërmarrësit Albtelecom Sh.A., me shkresa përkatëse i janë drejtuar AKEP-it edhe sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.A., AMC Sh.A., dhe Eagle Mobile Sh.A, duke sugjeruar gjithashtu amendimin e Ofertave Referencë të Interkoneksionit respektive, për të njejtën arsye të parashtruar edhe nga sipërmarrësi Albtelecom Sh.A.
4. Propozimet e Albtelecom-it krahasuar me ato të tre operatorëve celularë, përgjithësisht në thelb janë të ngjashme, por kanë edhe ndryshime për shkak edhe të përmbajtjes së ndryshme të Ofertave Referencë të Interkoneksionit të Albtelecom-it me tre operatorët celularë të cituar më sipër. Vendosja atje ku është e mundur nga AKEP-i, e një përmbajtje me formulim të njejtë për ato propozime të cilat konsiderohen të ngjashme midis këtyre operatorëve, i vjen në ndihmë palëve të interesuara për të ndërtuar të njejtin kuptim mbi termat e Ofertave Referencë të Interkoneksionit, pamvarsisht identitetit të operatorëve me FNT.
5. Disa nga propozimet e sipërmarrësit Albtelecom Sh.A., nuk konsiderohen të nevojshme, të drejta dhe të bazuara ligjërisht dhe për këtë arsye nuk pranohen nga AKEP-i, duke e reflektuar qëndrimin tek dispozitivi i këtij vendimi dhe Aneksi 1 bashkëlidhur.
6. Propozimet e dhëna më sipër, të pranuar nga AKEP-i për amendimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit, reflektojnë qëndrimet rregullatore të AKEP-it të vendosura nëpërmjet akteve normative dhe individuale administrative të nxjerra pas periudhës së publikimit dhe hyrjes në fuqi të kësaj Oferte Referencë të Interkoneksionit në zbatim. Ato përmirësojnë ndieshëm kuadrin rregullator lidhur me kushtet për lidhjen e marrëveshjeve të interkoneksionit në përputhje me detyrimet ligjore dhe kushtet aktuale të tregut. Garantojnë më mirë këkesën ligjore për kushtet e veçanta, për ndershmërinë, mosdiskriminimin, transparencën dhe arsyeshmërinë gjatë procesit të negociimit midis sipërmarrësve për lidhjen e Marrëveshjeve të Interkoneksionit (MI). Pas miratimit të shtesave dhe ndryshimeve në Ofertat referencë të Interkoneksionit, është e nevojshme që ato të reflektohen edhe në marrëveshjet e interkoneksionit të lidhura nga sipërmarrësi Albtelecom Sh.A., me operatorët e tjerë.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme, në zbatim të shkronjën c) të nenit 8 dhe nenin 52 të ligjit nr. 9918 dhe Rregullores Nr. 19, datë 14.06.2010 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, e ndryshuar,

V E N D O S :

1. Të pranojë pjesërisht propozimet e sipërmarrësit Albtelecom Sh.A., për disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit në zbatim dhe t'i miratojë ato sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi (Aneksi 1).
2. Përveç sugjerimeve të sipërmarrësit Albtelecom Sh.A., të pranuar nga AKEP-i sipas pikës 1 të këtij dispozitivi, në Ofertën Referencë të Interkoneksionit në zbatim, AKEP sipas dokumentit bashkëlidhur (Aneksi 1) vendos edhe disa shtesa dhe ndryshime të tjera që i konsideron të nevojshme.
3. Ndërhyrja legjislative sipas këtij vendimi do të bëhet pjesë e marrëveshjeve të interkoneksionit të lidhura midis Albtelecom-it dhe paleve të tjera, me efekte nga data e përcaktuar nga AKEP për hyrjen në fuqi të tyre, si më poshtë:
 - a. Për hyrjen në fuqi të ndryshimit në lidhje me tarifën e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare (nga nën-rregullim në komerciale), do të zbatohet afati i përcaktuar në vendimet e KD të AKEP, Nr.1739, 1740, 1741 dhe 1742, datë 20.12.2011, që ndryshimi hyn në fuqi më datë 01.02.2012;
 - b. Amendimet e Ofertës Referencë të Interkoneksionit në zbatim, të miratuara në këtë vendim, do të duhet të hyjnë në fuqi në datën e mbarimit të periudhës tranzitore të përcaktuar në Rregulloren e Autorizimit të Përgjithshëm, pra më datë 09.05.2012.
4. Aneksi 1 sipas këtij vendimi, të publikohet nga sipërmarrësi Albtelecom Sh.A., brenda 7 ditëve pas marrjes së njoftimit vendimit.
5. Vendim të publikohet në faqen e internetit te AKEP: www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Alketa MUKAVELATI**
3. **Benon PALOKA**
4. **Zamira NURCE**

ANEKSI 1

SHTESAT DHE NDRYSHIMET NE OFERTËN REFERENCË TË INTERKONEKSINIT NË ZBATIM TË SIPERMARRËSIT ALBTELECOM SH.A., TË MIRATURA NGA AKEP-I ME VENDIMIN E KËSHILLIT DREJTUES

Nr. ____, DATË ____ .04. 2012

1. Në nenin 4 “Baza Juridike” shtohen pikat 2/2, 2/3, 3/4, 3/5, 3/6, 3/7, 3/8, 3/9, 5/i, 5/k dhe pika 6, 7, si dhe ndryshon paragrafi i parë i pikës 5, si më poshtë:
 - 2/2 *Vendimin nr. 1742 dt. 20.12.2011, i Këshillit Drejtues të AKEP për “Shfuqizimin e VKD nr.1439 datë 3.11.2010 “Disa ndryshime në VKD nr. 1348, date 26.07.2010 “ Për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom Sh.A., me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me pakicë të telefonisë fikse dhe tregjet me shumicë të interkoneksionit të telefonisë fikse””;*
 - 2/3 *Vendimin nr. 1774 dt. 02. 02. 2012 “Për miratimin e dokumentit “Rregullore për Autorizimin e Përgjithshëm”;*
 - 3/4 *Rregulloren nr. 16, datë 16. 04. 2010 “Për treguesit e cilësisë”, miratuar me VKD Nr. 1256, datë 16. 04. 2010;*
 - 3/5 *Rregulloren nr. 18, datë 11. 06. 2010 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, miratuar me VKD Nr. 1296, datë 11. 06. 2010;*
 - 3/6 *Rregulloren “Për portabilitetin e numrit” miratuar me VKD Nr. 1219, datë 07. 04. 2010;*
 - 3/7 *VKD Nr. 1318, datë 14. 06. 2010 “Për miratime specifike teknike për portabilitetin e numrit”;*
 - 3/8 *Rregullore Nr. 17, datë 16. 04. 2010 “Për Administrimin e Kodeve të Pikave të Sinjalizimit Kombëtar (NSPC) dhe Ndërkombëtar (ISPC) për interkoneksionin e rrjeteve, miratuar me VKD Nr. 1257, datë 16. 04. 2010;*
 - 3/9 *Rregullre Nr. 22, datë 24. 06. 2011 “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kablore dhe rrjeteve me fibra optike ndërrurbane të komunikimeve elektronike”.*
5. *Operatori Përfitues, si kusht për fillimin e negociatave me Albtelecom paraqet së bashku me kërkesën për interkoneksion:*
 - a. *Çertifikatën e Konfirmimit të Njoftimit (Kopje);*
 - b. *Autoizimin Individual për caktimin dhe përdorimin e frekuencave (në rast se do të përdorë frekuenca)(Kopje);*

- c. *Autorizimin Individual për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike (Kopje).*

Kërkesa duhet gjithashtu të përmbajë informacionin e nevojshëm për të mundësuar zgjidhjen teknike dhe komerciale të akses interkoneksionit të tilla si ...

- 5/i *Parashikimi për trafikun që do të shkëmbehet të jepet i detajuar siç është parashikuar tek pika 3 e Aneks 8 “Parashikime dhe Porosia për Kapacitete” Ofertës Referencë të Interkoneksionit në zbatim.*
- 5/k *Historikun e të dhënave për trafikun e gjeneruar nga abonentët e Operatorit përfitues (origjinim/tranzitim/terminim) siaps raporteve të dorëzuara në AKEP periodikisht.*
6. *Kërkesa do të konsiderohet e plotë vetëm pas plotësimit me të gjithë dokumentat dhe informacionet e sipërpërmendura si dhe të dhënat e detajuara të specifikuara në nenin 9, pika 2/1 të Ofertës Referencë të Interkoneksionit në zbatim.*

2. Pika 2/1 e nenit 9 “Interkoneksioni me rrjetin Albtelecom”, ndryshon dhe bëhet si më poshtë:

2/1 *Ndërmjet të dhënave të detajuara që duhet të paraqiten së bashku me kërkesën për interkoneksion janë edhe:*

- 1) *Kodin(et) e Pikës(ave) të Sinjalizimit (NSPC) sipas rekomandimeve të SS7 të caktuara nga AKEP-i.*
- 2) *Operatori Përfitues që kërkon të terminojë apo tranzittojë trafik ndërkombëtar në rrjetin Albtelecom, përveç sa më sipër, duhet të disponojë dhe të paraqesë pranë Albtelecom:*
 - a) *Kodin(et) Ndërkombëtar të Pikës së Sinjalizimit (ISPC) sipas rekomandimeve të SS7 të caktuar nga AKEP-i.*
 - b) *Kopje të marrëveshjes(ve) të Operatorit Përfitues me Operatorin Ndërkombëtar ku të jetë vendosur edhe ISPC e Operatorit Ndërkombëtar.*
 - c) *Tabelen e rrugëzimeve të trafikut ndërkombëtar duke siguruar të paktën dy rrugëzime për secilin destinacion*
- 3) *Historikun e të dhënave për trafikun e gjeneruar nga abonentët e Operatorit Përfitues (origjinim/tranzitim/terminim) sipas raporteve të dorëzuara në AKEP periodikisht.*
- 4) *Procedurat dhe sistemet e informacionit që kanë të bëjnë me trajtimin dhe matjen e treguesve të cilësisë, sipas Rregullores për Treguesit e Cilësisë së Shërbimit, përfshirë këtu Manualin përkatës dhe dokumentat përbërës, sipas nenit 7 të kësaj Rregulloreje.*

- 5) Vetedeklarimin lidhur me aftësinë për të kryer rrugëzimin e duhur të thirrjeve, sipas përcaktimeve të Rregullores “Për Portabilitetin e Numrit”, e ndryshuar;
 - 6) Masat e marra nga Operatori Përfitues për sigurimin e aksesit pa pengesë në shërbimet e emergjencës në përputhje me seksionin 23 të Aneksit C të Rregullores për Autorizimin e Përgjithshëm.
 - 7) Vetedeklarimin mbi ekzistencën ose jo të sistemeve që mundësojnë lejimin e përgjimit nga autoritetet kompetente, sipas legjislacionit në fuqi për përgjimin telekomunikimeve.
- 2/2 Operatori Përfitues duhet të garantojë në çdo kohë kërkesat e mëposhtme rregullatore. Mosrespektimi i ndonjë prej tyre, i jep Albtelecom të drejtën për t’iu drejtuar AKEP-it me kërkesë për pezullimin e shërbimit deri në rivendosjen e situatës sipas standardeve dhe parashikimeve rregullatore:
- a) Procedurat dhe sistemet e informacionit që kanë të bëjnë me trajtimin dhe matjen e treguesve të cilësisë, sipas Rregullores për Treguesit e Cilësisë së Shërbimit, përfshirë këtu Manualin përkates dhe dokumentat përbërës, sipas nenit 7 të kësaj Rregulloreje.
 - b) Garantimin e aksesit në çdo kohë nga përdoruesit e Operatorit përfitues drejt numrave të emergjencës dhe garantimin e informacionit për identifikimin e vendodhjes së personit që ka kryer thirrjen.
 - c) Garantimin në çdo kohë të sigurisë, integritetit dhe mirëmbajtjes së funksioneve të rrjeteve të komunikimit elektronik.
 - d) Garantimin dhe sigurimin e mbrojtjes së të dhënave personale në lidhje me të dhënat nga trafiku i shëmbyer mes palëve në përputhje me Direktivën e EU mbi mbrojtjen e të dhënave dhe Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Tek Aneks 1 “Përkufizime”, përkufizimi i shërbimit të terminimit në rrjetin Albtelecom ndryshon, si dhe shtohet përkufizimi i shërbimit të terminimit të trafikut ndërkombëtar, si më poshtë:
- “Shërbimi i Terminimit të trafikut kombëtar në Albtelecom”*
- Shërbimi nëpërmjet të cilit Albtelecom, në emër të Operatorit Përfitues përcjell Thirrjet kombëtare të këtij të fundit, ose të tranzituara prej tij, nga Pika e Interkoneksionit për në një Pikë fundore të Rrjetit të tij në Republikën e Shqipërisë, të identifikuar nëpërmjet numrave të abonenteve/ pajtimtareve të Albtelecom.*
- “Sheëbimi i Terminimit të trafikut ndërkombëtar në Albtelecom”*
- Shërbimi nëpërmjet të cilit Albtelecom, në emër të Operatorit Përfitues përcjell Thirrjet ndërkombëtare, të tranzituara nga ky i fundit, nga Pika e Interkoneksionit për në një Pike fundore të Rrjetit të tij në Republikën e Shqipërisë, të identifikuar nëpërmjet numrave të abonentëve/pajtimtarëve të Albtelecom*
4. Tek Aneks 6 “Çështje teknike”, bëhet një shtesë tek pika 4., si më poshtë:

4.1...Ky kapacitet konfigurohet i ndarë sipas kategorisë së trafikut, dedikuar veçmas për trafik kombëtar dhe veçmas për atë ndërkombëtar.

5. Tek Aneks 6 “Çështje teknike”:

- a) titulli i pikës 7.3 ndryshon, **7.3. Kodet e Pikave të Sinjalizimit Kombëtar (National Signalling Point Codes - NSPC) dhe Kodet e Pikave të Sinjalizimit Nderkombetar (International Signalling Point Codes-ISPC)**
- b) si dhe tek përmbajtja e pikës 7.3 bëhet shtesa, si më poshtë:
Kodi i Pikës së Sinjalizimit Ndërkombëtar (International Signaling Point Code-ISPC) i centralit të Operatorit Përfitues është:

6. Tek Aneks 4 “Tarifat e Shërbimeve”, në pikën I.1.1.1 Shërbimi Trafikut të terminimit sipas pikës I.1.1.1.b, në vend të vlerës së tarifës vendoset:

Tarife komerciale

7. Tek Aneks 12, Marrveshja e Nivelit të Shërbimit (SLA) , në fund të Seksion 6 të shtohet teksti i mëposhtëm:

Matjet për treguesit e cilësisë së trafikut të behen të ndara për trafikun e thirrjeve hyrëse me origjinë Kombëtare, Ndërkombëtare dhe trafikun drejt numrave të portuar.